

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar kolegji, Shqipe Qerimi e Hashim Çollaku, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional, Jeton Leci, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.A. nga fshati ..., komuna e Mitrovicës, për shkak të veprës penale vjedhje, parashikuar me nenin 325 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.134/2016 datë 22.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur 08.08.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.134/2016 datë 22.05.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.134/2016 datë 22.05.2018, të akuzuarin S.A., bazuar në nenin 364 par.1.nënpar.1.3 të KPPK e ka liruar nga akuza se ka kryer veprën penale vjedhje, parashikuar me nenin 325 par.1 të KPRK. Shpenzimet e procedurës i janë vënë në barrë mjeteve buxhetore të gjykatës ndërsa të dëmtuarit I.A., N.A. dhe N.A.2, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, janë udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që kjo Gjykatë ta anuloj aktgjykimin e kundërshtuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit me shkresën PPA/II.nr.666/18 datë 29.06.2018 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit, aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit pasi i shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitë e nenit 394 të KPP, dhe pasi që i vlerësoi pretendimet në ankesë gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar.

Prokurori me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e goditur ka bërë shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1. nga se aktgjykimi nuk është i përpiluar në pajtim me nenin 370 pika 7 të KPPK ku dispozitivi i aktgjykimit është i pa qartë dhe kontradiktor në mes veti me ç'rast gjykata nuk ka analizuar faktet relevante të kësaj çështjeje penalo-juridike dhe nuk ka bërë krahasimin adekuat të provave veçanërisht nuk ka krahasuar deklaratën e të dëmtuarit në relacion me deklaratën e dëshmitarit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e lartë cekura nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 të KPPK-së për të cilat pretendohet në ankesë, apo shkelje të tjera të cilat gjykata e shkallës së dytë në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së i vëren detyrimisht, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Kështu, me aktgjykimin e ankimuar, pra edhe dispozitivi i tij është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, nuk përmban kundërtënie me vetveten ose me arsyet e paraqitura. Përshkrimi i dhënë në dispozitiv i përmban të gjitha arsyet, faktet relevante të cilat janë dhënë në mënyrë koncize, kështu që në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërtënie ose dubioze. Aktgjykimi i ankimuar përmban arsye të duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështjeje juridiko penale, e të cilat arsye si të drejta dhe të ligjshme i mbështet edhe kjo gjykatë, sepse kanë mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe kolegji penal i Gjykatës së Apelit nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësimin për këtë.

Prokurori me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor veprat e kryera janë vërtetuar pjesërisht nga deklaratat e dëshmitarëve- të dëmtuarëve, të cilët kanë vërtetuar vjedhjen e sendeve në shtëpitë e tyre ashtu siç është përshkruar në aktakuzë si dhe nga dëshmia e dëshmitarit I.U., i cili ka deklaruar se dëshmitari I.A. ka qenë i bindur se të gjitha këto vjedhje i ka kryer tani i akuzuari. Sipas ankesës, i akuzuari është recidivist sepse në një rast është dënuar me aktgjykim të formës së prerë dhe se ndaj tij zhvillohen edhe procedura tjera penale mirëpo gjykata e shkallës së parë vetëm në bazë të mbrojtjes së të akuzuarit, e liron të njëjtin duke mos i vlerësuar edhe provat tjera.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, me aktgjykimin e ankimuar, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe konkret, në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme juridike dhe faktike, të cilat, si të drejta, i aprovon edhe kjo Gjykatë. Gjukata e shkallës së parë ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të KPPK, duke e paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për cilat arsye i merr si të vërtetuara ose të pa vërtetuara e duke dhënë vlerësimin e saktësisë së provave kontradiktore. Ajo ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat i aprovon edhe kjo Gjykatë. Gjukata e shkallës së parë për ndriçimin e rastit konkret, ka marrë në pyetje në cilësi të dëshmitarëve tani të dëmtuarit I., N. dhe N.A.2n të cilët në shqyrtimin gjyqësor kanë dhënë

deklaratat e tyre lidhur me ngjarjen. Në rastin konkret nuk është kontestuese se në shtëpitë e të tre të dëmtuarve kanë ndodhur vjedhjet ashtu siç është e përshkruar në aktakuzë mirëpo që të tre të dëmtuarët në shqyrtimin gjyqësor kanë deklaruar se i kanë vërejte vjedhjet e kryera në shtëpitë e tyre dhe faktin se të gjithëve u mungonin në shtëpi sendet e vjedhura por njëherit kanë deklaruar se nuk e kanë parë askënd e as tani të akuzuarin duke e kryes veprën e vjedhjes. Në shqyrtimin gjyqësor është dëgjuar edhe zyrtari policor I.U., i cili ka deklaruar se i dëmtuari I.A. i ka thënë se është i bindur se vjedhjet i ka kryer tani i akuzuari mirëpo i njëjti nuk ka dhënë asnjë provë të vetme për bindjen e tij se tani i akuzuari është kryerës i vjedhjeve të cekura në aktakuzë. I akuzuari ka mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar dhe gjykata e shkallës së parë ia ka falur besimin kësaj deklaratë duke pasur parasysh faktin se të dëmtuarit e lart cekur nuk e kanë parë kryerësin e vjedhjeve.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nga arsyetimi i aktgjykimit rrjedh se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me veprën penale objekt i aktgjykimit të ankimuar nga se i akuzuari nuk ka pranuar veprën penale, nga dëshmitë e tani të dëmtuarve I., N. dhe N.A.2 si dhe dëshmisë së zyrtarit policor I.U., gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se në rastin konkret i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Bazuar në deklaratat e të lart cekurve, gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar asnjë veprim të akuzuarit i cil veprim i ka shkaktuar dëme të dëmtuarve.

Kolegji penal i kësaj Gjykate vlerëson se barra e provave i takon prokurorisë, e cila në rastin konkret nuk ka arritur që të sigurojë prova konkrete që të vërtetojë fajësinë e të akuzuarit ndërsa fakti se tani i akuzuari më parë ka qenë i dënuar si dhe provat e administruara nuk kanë provuar se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën i akuzuari S.A. është akuzuar ndërsa është liruar nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Prokurori aktgjykimin e ankimuar e kundërshton edhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, mirëpo kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se meqë gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, drejtë është aplikuar edhe ligji penal kur i akuzuari është liruar nga aktakuza për veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, e cila i vihet në barrë me akuzë.

Kështu, bazuar në këto rrethana, kolegji penal vlerëson se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë, i ligjshëm dhe i pranueshëm edhe për këtë Gjykatë.

Nga sa u tha më lartë e sipas dispozitës së nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

PA1.nr. 659/18 me datë 08.08.2018

Bashkëpunëtori profesional
Jeton Leci

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,
1. Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

2. Shqipe Qerimi

3. Hashim Çollaku